**LIGJ**
**Nr. 10 348, datë 11.11.2010**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE SIGURIMIN ME BURIME NJERËZORE TË QENDRËS SË NATO-S PËR BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në memorandumin e mirëkuptimit për ngritjen, organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe sigurimin me burime njerëzore të qendrës së NATO-s për Bashkërendimin e Operacioneve Speciale (NSCC).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6780, datë 23.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)**
NDËRMJET DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË BELGJIKËS, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË, DHE DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË KANADASË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ÇEKISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË DANIMARKËS, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS FRANCEZE, DHE MINISTRISË FEDERALE TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS ITALIANE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË LETONISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË LITUANISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË HOLANDËS, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË NORVEGJISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË POLONISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS PORTUGEZE, DHE MINISTRISË RUMUNE, TË MBROJTJES KOMBËTARE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SLLOVAKE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË SPANJËS, DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË TURQISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT, DHE SHTABIT SUPREM TË FUQIVE ALEATE PËR EUROPËN (SHAPE), NË LIDHJE ME NGRITJEN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE SIGURIMIN ME BURIME NJERËZORE TË QENDRËS SË NATO-S PËR BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)

HYRJE

Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara, Ministri i Mbrojtjes i Mbretërisë së Belgjikës, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Bullgarisë, Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës Çeke, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Danimarkës, Ministri i Mbrojtjes i Republikës Franceze, Ministria Federale e Mbrojtjes e Republikës Federale të Gjermanisë, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Hungarisë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës Italiane, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Letonisë, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Lituanisë, Ministri i Mbrojtjes i Mbretërisë së Holandës, Ministri i Mbrojtjes i Mbretërisë së Norvegjisë, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Polonisë, Ministri i Mbrojtjes i Republikës Portugeze, Ministria Rumune e Mbrojtjes Kombëtare, Ministria e Mbrojtjes e Republikës Sllovake, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Sllovenisë, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Spanjës, Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleate për Europën, në vijim referuar kolektivisht si "Nënshkruesit",

*duke pasur* parasysh se, në vijim të Traktatit të Atlantikut të Veriut, nënshkruesit dëshirojnë që të bashkojnë përpjekjet e tyre për mbrojtje kolektive në një bashkëpunim edhe më të ngushtë;

*duke mbajtur* parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut në lidhje me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA), të nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 dhe protokollin mbi statusin e Shtabit Ndërkombëtar Ushtarak, të ngritur në pajtim me Traktatin e Atlantikut të Veriut, të nënshkruar në Paris më 28 gusht 1952 (Protokolli i Parisit);

*duke mbajtur* parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Shtabit Suprem të Fuqive Aleate për Europën (SHAPE) dhe Mbretërisë së Belgjikës në lidhje me kushtet e veçanta të zbatueshme për ngritjen dhe operimin e këtij shtabi në territorin e Mbretërisë së Belgjikës, të nënshkruar në Bruksel më 12 maj 1967 (Marrëveshja SHAPE – Belgjikë);

*duke pasur* parasysh se në Rigë, më 29 nëntor 2006, kryetarët e shteteve dhe të qeverive të Aleancës së NATO-s ranë dakord për fillimin e një nisme për shndërrimin e forcave të operacioneve speciale, me qëllim rritjen e aftësisë së tyre për t'u stërvitur dhe për të operuar së bashku, duke përfshirë përmirësimin e kapaciteteve të pajisjeve të tyre;

*duke vërejtur* se dokumenti NATO MCM – 143 – 2006 "Këshillimi mbi nismën (NSTI) e shndërrimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) të NATO-s", i datës 15 shtator 2006, miratoi konceptin bazë të NSTI-së, por përmes referimeve të mëvonshme, i kërkoi SHAPE që të japë më shumë hollësi mbi Qendrën e Koordinimit të Operacioneve Speciale të NATO-s (NSCC);

*duke vërejtur* se dokumenti NATO MCM – 0190 – 2006 "Këshillimi mbi nismën (NSTI) e shndërrimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) të NATO-s" u miratua nga Komiteti Ushtarak (MC) dhe ofroi më shumë informacione të hollësishme mbi vlerën, rolin dhe përgjegjësitë e NSCC-së;

*duke vërejtur* se përmes dokumentit NATO MCM – 0856 – 2006 "Implementimi i Nismës (NSTI) së shndërrimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) të NATO-s", të datës 12 dhjetor 2006, Shtabi Ndërkombëtar Ushtarak i NATO-s (IMS) miratoi NSTI-në dhe ngarkoi SHAPE për të nisur implementimin e tri elementeve të NSTI;

*duke vërejtur* se dokumenti NATO MCM – 0069 – 2008 "Këshillimi mbi nismën (NSTI) e shndërrimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) të NATO-s", që u miratua nga Komiteti Ushtarak, rikonfirmoi edhe më tej vendndodhjen e NSCC pranë SHAPE dhe, si rrjedhojë reduktimin e strukturës (PE) të Zyrës së Operacioneve Speciale të SHAPE (SSOO) në kohë paqeje dhe këshilloi më tej NAC mbi vendndodhjen e "Drejtuesit të Operacioneve Speciale" si pjesë e Shtabit Special të SHAPE pranë SACEUR;

*duke vërejtur* se më 22 dhjetor 2006, SACEUR caktoi COMSOCEUR si drejtuesin e parë të NSCC dhe e ngarkoi atë me përgjegjësinë e fillimit të zbatimit të NSCC, duke pasur Shtetet e Bashkuara të Amerikës si "Vendin kuadër";

*duke vërejtur* zhvillimin e një marrëveshjeje teknike ndërmjet SHAPE dhe Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lidhje me komandën dhe kontrollin e NSCC nga

NATO-ja;

*duke vërejtur* se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si vendi kuadër, do të sigurojë mjediset dhe pajisjet fillestare për ngritjen e NSCC;

*duke vërejtur* se NSCC është një qendër bashkërendimi dhe këshillimi pa funksion komandimi;

*duke vërejtur* se rishikimet e ardhshme të PE-së të strukturës së komandimit të NATO-s (NCS) të kryera nga ana e NAC mund të konsiderojnë NSCC si të pranueshme për t'u shndërruar në një shtab ndërkombëtar ushtarak të financuar bashkërisht të NATO-s;

*duke vërejtur* se gjuha zyrtare e NSCC është anglishtja;

*duke dëshiruar* që të zbatojnë ato marrëveshje shumëkombëshe të organizimit, administrimit, burimeve njerëzore, sigurimit dhe financimit që janë të nevojshme për ngritjen e NSCC si organ ushtarak i NATO-s me statusin e një Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar (IMHQ);

*duke pasur* parasysh dokumentin C – M (2002) 49 [Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO)] të datës 17 qershor 2002;

*duke vërejtur* se ky Memorandum Mirëkuptimi miratohet mbi parakushtin që NSCC të jetë e vendosur pranë SHAPE, në Mons, Belgjikë;

*duke vërejtur* se shtetet joanëtare të NATO-s, organizatat ndërkombëtare ose organizatat joqeveritare (OJQ) mund të marrin pjesë në NSCC nëse mbështeten nga cilido pjesëmarrës, sipas kuadrit të miratuar nga NAC për vendet joanëtare të NATO-s ose organizatat ndërkombëtare, ose organizatat joqeveritare që marrin pjesë në veprimtaritë e NATO-s dhe/ose operacionet e udhëhequra nga NATO-ja në përputhje me PO (98) 83 dhe MC 0567;

*rrjedhimisht,* nënshkruesit kanë arritur mirëkuptim për sa më poshtë:

Seksioni I

**Përkufizime**

Përveçse kur një kuptim është përcaktuar me hollësi ndryshe në këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe në cilindo dokument vijues, do të zbatohet fjalori i termave dhe përkufizimeve të NATO-s (AAP – 6), si edhe fjalori i shkurtimeve të NATO-s i përdorur në dokumentet dhe publikimet e NATO-s (AAP – 15). Përveç termave të përkufizuar në dispozita të tjera të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, termat e përkufizuar më poshtë do të kenë kuptimet e deklaruara kur përdoren këtu dhe në çdo dokument vijues:

1.1 "Vendi aplikues" nënkupton një vend të NATO-s që kërkon t'i bashkohet këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

1.2 "Informacion i klasifikuar" nënkupton informacionin zyrtar që kërkohet të mbrohet në interes të NATO-s dhe/ose sigurisë kombëtare të një pjesëmarrësi dhe caktohet nga zbatimi i shenjave të klasifikimit të sigurisë.

1.3 "COMSOCEUR" nënkupton komandantin, Komandën e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara, Europë.

1.4 "Personat në varësi" nënkupton ata persona që përkufizohen në nenin 1 paragrafi 1 (c) të NATO SOFA dhe në cilëndo marrëveshje që shton apo zbaton Protokollin e Parisit.

1.5 "Vendi kuadër" nënkupton pjesëmarrësin që është përgjegjës për ofrimin e një mbështetje të caktuar, siç përcaktohet në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

1.6 "Vendi pritës" nënkupton pjesëmarrësin në territorin sovran të të cilit vendoset NSCC.

1.7 "Informacion" nënkupton çdo komunikim, marrje të njohurive apo zbulimeve, pavarësisht nga forma ose tipi, përfshirë këtu edhe ato të natyrës teknike apo shkencore, dhe duke përfshirë gjithashtu fotografitë, raportet e përkohshme dhe përfundimtare, manualet, të dhënat për rreziqe, të dhënat eksperimentale, testet, projektet, specifikimet, proceset, teknikat, shpikjet, skicimet, programet kompjuterike përfshirë kodet burimore, shkrimet teknike, regjistrimet zanore, paraqitjet pamore dhe paraqitje të tjera grafike, qofshin në shirita magnetikë, në memorie kompjuterike, ose në çdo formë tjetër dhe pavarësisht nëse u nënshtrohen apo jo të drejtave të autorit, shpikjes apo formave të tjera të mbrojtjes ligjore.

1.8 "Element i mbështetjes kombëtare (NSE)" nënkupton çdo njësi apo element kombëtar që mbështet anëtarët përkatës vendas të personelit të NSCC dhe/ose personelin e mbështetur të tyre.

1.9 “NSCC” nënkupton Qendrën e Bashkërendimit të Operacioneve Speciale të NATO-s të vendosur pranë SHAPE në Mons, Belgjikë.

1.10 “Drejtori i NSCC” është oficeri që drejton NSCC dhe këshilltari kryesor i SACEUR në fushën e operacioneve dhe shndërrimit të SOF.

1.11 “Anëtarët e personelit të NSCC” nënkupton personelin e caktuar në pozicionet e punës së NSCC si pjesë e strukturës së burimeve njerëzore të pasqyruar në shtojcën B.

1.12 “Pjesëmarrës” nënkupton ata ministra/ministri/departamente të mbrojtjes/shtabe të përgjithshme të shteteve anëtare të NATO-s që kanë dhënë pëlqimin për t’u përfaqësuar në NSCC në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

1.13 “SACEUR” nënkupton komandantin suprem të Forcave Aleate për Europën.

1.14 “Përfaqësues i lartë kombëtar (SNR)” nënkupton oficerin e lartë të secilit pjesëmarrës të caktuar në NSCC.

1.15 “Komiteti i Lartë i Politikave dhe Burimeve (SPRC)” nënkupton organin që përbëhet nga përfaqësuesit e nënshkruesve, termat e referencës së të cilit jepen në shtojcën C.

1.16 “Nënshkruesit” nënkupton pjesëmarrësit dhe SHAPE.

1.17 “Sponsor (mbështetës)” nënkupton pjesëmarrësin që vepron si “vendi mbështetës (sposorizues) i NATO-s” për një vend, organizatë ndërkombëtare apo organizatë joqeveritare joanëtare të NATO-s që merr pjesë në organin përkatës ushtarak/teknik të Aleancës, në Komitetin Politik dhe NAC, në përputhje me PO (98) 83 “Udhëzime të përgjithshme mbi Kontaktet e NATO-s me vendet joanëtare të NATO-s, vendet jopartnere dhe vendet që nuk janë pjesë e Dialogut Mesdhetar” dhe me MC 0567 “Procedurat për pranimin e kontributit në trupa ndaj operacioneve të udhëhequra nga NATO-ja nga vende joanëtare të NATO-s” apo me politikën e ardhshme për të cilën do të bihet dakord nga NATO-ja në veprimtaritë e përhershme apo të përkohshme të NSCC.

1.18 “I sponsorizuar (i mbështetur)” nënkupton cilindo vend, organizatë ndërkombëtare apo organizatë joqeveritare joanëtare të NATO-s, pjesëmarrja e të cilit/së cilës në veprimtaritë e NATO-s dhe / ose operacionet e udhëhequra nga NATO-ja është miratuar nga NAC.

1.21 “Personel i sponsorizuar (i mbështetur)” nënkupton personelin që i përket një të sponsorizuari (të mbështeturi) dhe që merr pjesë në NSCC.

Seksioni II

**Qëllimi dhe objekti**

2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është që të bëjë parashikime për ngritjen, organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe sigurimin me burime njerëzore të NSCC, si dhe të shtrojë për zgjidhje çështjen e mbështetjes me pajisje, asaj administrative dhe jologjistike, dhe të përcaktojë dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e personelit që caktohet në të.

2.2 Objekti i këtij Memorandumi Mirëkuptimi bazohet në konceptin e nismës për shndërrimin e Forcave të Operacioneve Speciale të NATO-s (NSTI), duke pasur NSCC si pjesën kryesore të NSTI. Ky koncept ka qenë baza për MCM – 143 – 2006, MCM – 190 – 2006 dhe MCM – 0069 – 2008. Objekti i Memorandumit të Mirëkuptimit mbështet propozimin që NSCC të jetë një organizatë shumëkombëshe në formën e një qendre këshillimore dhe bashkërenduese jashtë strukturës komanduese të NATO-s, pa funksione komanduese, me tërësinë e përvojës dhe burimeve të SOF për të mundësuar trajnimin dhe punësimin e SOF të NATO-s; që të sinkronizojë SOF në të tërë Aleancën e NATO-s, në bashkërendim me SHAPE, Komandat e Forcave të Bashkuara (JFC-të), si dhe entet kombëtare SOF për të siguruar unitet në përpjekjet e SOF të NATO-s. Memorandumi i Mirëkuptimit mbështet aftësinë e NSCC për të integruar planifikimin e SOF të NATO-s për të siguruar politika dhe doktrina të përbashkëta të SOF, mbështet procesin e gjenerimit të forcave të SOF të NATO-s, si dhe përmirëson ndërveprueshmërinë e forcave të pjesëmarrësve.

Seksioni III

**Misioni dhe marrëveshjet e komandimit**

3.1 NSCC mundëson dhe mbështet operacionet speciale të NATO-s kudo në Aleancë dhe siguron pikën e kontaktit për ekspertizën e operacioneve speciale të NATO-s ndaj SACEUR dhe ndaj komandantëve të tjerë të ACO.

Detyrat kryesore të NSCC janë:

a) të sigurojë një lidhje të drejtpërdrejtë për SACEUR tek ekspertiza e SOF të NATO-s përmes një oficeri me grada madhore;

b) t'i ofrojë SACEUR konsulencë efektive dhe në kohën e duhur nga SOF, në mbështetje të planifikimit dhe zbatimit të operacioneve;

c) të bashkërendojë dhe sinkronizojë SOF të NATO-s në mbështetje të procesit të gjenerimit të forcave;

d) të shndërrojë vlerësimet strategjike të SOF në kërkesa të SOF dhe në konsulentë për përdorimin e SOF;

e) të zhvillojë e të publikojë politikat dhe doktrinën e SOF të NATO-s për të nxitur ndërveprueshmërinë dhe standardizimin e SOF të NATO-s;

f) të bashkërendojë, sinkronizojë dhe mbështesë arsimimin, trajnimin dhe stërvitjen e SOF të NATO-s;

g) të bashkërendojë trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve përmes një federate të qendrave stërvitore të SOF të NATO-s.

3.2 Detyrat e NSCC caktohen drejtpërdrejt dhe vetëm nga SHAPE. Marrëdhënia e varësisë dhe marrëdhëniet e komandës që mundësojnë NSCC që të kryejë detyrat e saj në kohë paqeje, krizash dhe operacionesh, do të jenë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Teknike të rënë dakord ndërmjet Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe SHAPE, e cila do të nënshkruhet pas nënshkrimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në vijim të këshillimeve të SHAPE me pjesëmarrësit.

Seksioni IV

**Baza ligjore dhe normative**

Sa vijon (bashkë me çdo shtesë) do të zbatohet për statusin dhe veprimtaritë e NSCC, anëtarët e personelit të NSCC, si dhe personat në varësi të tyre, sipas rastit:

4.1 Marrëveshja ndërmjet palëve të organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në lidhje me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA), nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951.

4.2 Pas vënies në veprim të NSCC si një organ ushtarak i NATO-s nga ana e Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC), statusi i Shtabit Ndërkombëtar Ushtarak (IMHQ) i parashikuar nga Protokolli i Parisit dhe çdo marrëveshje që plotëson apo zbaton Protokollin e Parisit.

4.3 Anëtarët e personelit të NSCC dhe personat në varësi të tyre do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si anëtarët e SHAPE dhe personat në varësi të tyre e si të tillë do të kenë të drejtë për përfitimet dhe shërbimet e përshtatshme, si dhe për privilegjet dhe imunitetet në shtrirjen që lejojnë marrëveshjet e zbatueshme.

4.4 Pa cenuar autoritetin e drejtorit të NSCC, anëtarët e personelit të NSCC caktohen pranë SHAPE dhe vendosen nën autoritetin e tij për të gjitha çështjet e drejtimit administrativ të përditshëm që lidhen me praninë e tyre në SHAPE, të vendosur në Belgjikë.

4.5 NATO PO (98) 83, udhëzimet e përgjithshme mbi kontaktet e NATO-s me vendet joanëtare të NATO-s, vendet jopartnere të NATO-s dhe vendet që nuk i përkasin Dialogut Mesdhetar.

4.6 MC 0567, procedurat për pranimin e kontributeve në trupa nga vendet joanëtare të NATO-s për operacionet e udhëhequra nga NATO-ja.

4.7 MC 437/1, Politika e Komitetit Ushtarak mbi operacionet speciale, 3 nëntor 2006.

4.8 MC 128/6, Udhëzuesi i politikave të NATO-s për zbulimin.

4.9 MC 167/3, Dhënia e informacionit ushtarak të klasifikuar dhe atij të paklasifikuar të NATO-s ndaj vendeve dhe organizatave joanëtare të NATO-s.

4.10 CM [2002] 49, Siguria brenda NATO-s.

4.11 MC 317, Struktura e forcave të NATO-s.

4.12 AD 45 - 1. Drejtimi dhe administrimi i personelit.

4.13 Memorandumi i Mirëkuptimit nuk do të jetë në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të pjesëmarrësve e as me cilëndo marrëveshje ndërkombëtare të zbatueshme. Në rastin e një mospërputhjeje të tillë, legjislacioni i pjesëmarrësve në fjalë apo marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme do të kenë përparësi.

Seksioni V
**Përgjegjësitë**

5.1 Vendi kuadër do të mbështesë NSCC në përputhje me shtojcën A.

5.2 Anëtarët e personelit të NSCC dhe personeli i caktuar në elementet e mbështetjes kombëtare (NSE) të tyre do të paguhen nga pjesëmarrësit që i sigurojnë ata, bashkë me përfitimet që janë të pagueshme sipas rregulloreve të tyre kombëtare.

5.3 Pjesëmarrësit do të veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat e rëna dakord në këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe veçanërisht do të plotësojnë vendet e vëna në dispozicion të tyre, siç tregohet në shtojcën B, me personel të kualifikuar në përputhje me përshkrimet përkatëse të punës.

5.4 Drejtori i NSCC do të jetë përgjegjës për përmbushjen e misionit, detyrave dhe për administrimin e NSCC, në përputhje me dispozitat e shtojcës D.

Seksioni VI
**Disiplina dhe detyrimet kombëtare**

6.1 Në lidhje me disiplinën dhe detyrimet kombëtare, drejtimi i anëtarëve të personelit të NSCC do të bëhet në përputhje me AD 45-1.

6.2 Përfaqësuesit e lartë kombëtarë (SNR) ose delegatët e tyre kanë, në lidhje me personelin e tyre, të gjitha fuqitë ose kompetencat që u janë dhënë atyre nga ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, në përputhje me Protokollin e Parisit dhe NATO SOFA.

6.3 Anëtarët e personelit të NSCC do të kryejnë detyrat sipas udhëzimeve të drejtorit të NSCC, në përputhje me misionin e NSCC. Këto detyra do të jenë në përputhje me ligjet e brendshme të pjesëmarrësve përkatës.

Seksioni VII
**Sigurimi i burimeve njerëzore dhe personeli**

7.1 Përveçse kur në këtë Memorandum Mirëkuptimi parashikohet ndryshe, ose siç vendoset nga SPRC, menaxhimi i anëtarëve të personelit të NSCC do të bëhet në përputhje me AD 45 – 1 dhe me të gjitha rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të NATO-s.

7.2 Kërkesat për shtesa ose pakësime në shpërndarjen e posteve, si dhe ndryshimet e përshkrimeve të punës do të shqyrtohen nga SPRC mbi baza vjetore, në përputhje me procedurat në shtojcën B. Një pjesëmarrës që pakëson burimet e tij njerëzore do të jetë përgjegjës për pjesën e tij të buxhetit të postit të prekur deri në fund të vitit fiskal, në të cilin mbaron periudha e njoftimit.

7.3 Në përputhje me AD 45 - 1, anëtarët e personelit të NSCC mund të marrin leje siç do të lejohet nga pjesëmarrësi përkatës. Secili pjesëmarrës do t'i japë drejtorit të NSCC një listë të festave zyrtare të zbatueshme.

7.4 Organigrama dhe burimet njerëzore të NSCC u nënshtrohen ndryshimeve të përkohshme në çdo kohë nga drejtori i NSCC, në përputhje me parimet e AD 45 - 1, për shkak të shqyrtimit të kërkesave të misionit, burimeve dhe kapaciteteve të disponueshme. Këto ndryshime do të rishikohen nga SPRC në takimin e tij të ardhshëm. Çdo ndryshim i përhershëm në organigramën e NSCC do të bihet dakord paraprakisht nga SPRC dhe do t'i raportohet MC.

7.5 Pjesëmarrësit mund të propozojnë në çdo kohë që të shtojnë apo ulin numrin e posteve të NSCC që u caktohen atyre, me kusht që për çdo ulje të propozuar të bihet dakord dhe të miratohet nga SPRC përmes drejtorit të NSCC të paktën 12 muaj përpara datës së hyrjes në fuqi. Çdo propozim i tillë do të merret në shqyrtim nga SPRC dhe do të trajtohet në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

7.6 Nëse një pjesëmarrës është përkohësisht i paaftë që të plotësojë një pozicion që i është caktuar për më shumë se 90 ditë, SNR i atij pjesëmarrësi (ose anëtari i SPRC në rast se pjesëmarrësi në fjalë nuk ka një oficer në dispozicion të caktuar pranë NSCC) do të njoftojë me shkrim drejtorin e NSCC. Drejtori i NSCC mund t'iu drejtohet më pas pjesëmarrësve të tjerë për të plotësuar postin derisa pjesëmarrësi i caktuar të mund të rimarrë atë post e ta plotësojë atë. Nëse një pjesëmarrës nuk është i aftë që të plotësojë një post që i është caktuar, në mënyrë të përhershme, posti mund t'i

caktohet më pas cilitdo pjesëmarrës që del vullnetar për këtë.

7.7 Drejtori i NSCC, përmes zinxhirit të komandës së NSCC, do të mbikëqyrë veprimtarinë e përditshme të anëtarëve të personelit të NSCC.

## Seksioni VIII
## **Mbështetja financiare**

8.1 Në përputhje me procedurat e miratuara nga NAC, pjesëmarrësit mund të mbështesin financiarisht vende joanëtare të NATO-s, organizata ndërkombëtare apo organizata joqeveritare që marrin pjesë në veprimtaritë e NATO-s dhe/ose operacionet e udhëhequra nga NATO-ja për pjesëmarrje në NSCC.

8.2 Mbështetja do t'i nënshtrohet politikës ekzistuese të rënë dakord nga NATO-ja në përputhje me vendimet e NAC mbi pjesëmarrjen e vendeve joanëtare të NATO-s, organizata ndërkombëtare apo organizata joqeveritare në veprimtaritë e NATO-s dhe/ose operacionet e udhëhequra nga NATO-ja për pjesëmarrje në NSCC.

8.3 Personeli i mbështetur financiarisht do të shërbejë pranë NSCC-së, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga SPRC.

8.4 Statusi ligjor i personelit të mbështetur financiarisht dhe personave në varësi te tyre, të cilët nuk mbulohen nga një marrëveshje mbi statusin e forcave dhe/ose rregullime shtesë, do t'u nënshtrohen rregullimeve me vendin pritës, vendin kuadër dhe/ose SHAPE.

8.5 Personeli i mbështetur financiarisht dhe personat në varësi të tyre do të kenë akses pranë shërbimeve mbështetëse në SHAPE në kushte të njëjta si anëtarët e personelit të NSCC dhe personat në varësi të tyre, në atë shtrirje që lejojnë marrëveshjet e zbatueshme.

8.6 Mbështetësit financiarë do të sigurojnë që i mbështeturi financiarisht (i sponsorizuari) do të mbulojë shpenzimet që rrjedhin nga veprimtaritë e personelit të mbështetur financiarisht në NSCC kundrejt nënshkruesve dhe palëve të treta, përveçse kur bihet dakord ndryshe nga SPRC. Kjo përfshin kostot e përmendura në nenin 11.1.

8.7 Brenda kufijve të vendosur nga ligjet dhe rregulloret e brendshme përkatëse, ose kur është e zbatueshme, rregullimet apo kontratat ndërkombëtare, mbështetësit financiarë përmes përfaqësuesve të tyre të lartë kombëtarë (SNR) ose delegatëve të tyre, do të jenë përgjegjës për personelin e tyre të mbështetur financiarisht për përputhshmërinë me rregulloret e nxjerra nga drejtori i NSCC.

8.8 Mbështetësit financiarë do të përfshijnë në rregullimet e tyre me të mbështeturit financiarisht (të sponsorizuarit) e tyre joanëtarë të NATO-s, jo PfP, dispozita në lidhje me pretendimet, të tilla që pretendimet e shkaktuara nga personeli i mbështetur financiarisht të mbulohen nga i mbështeturi financiarisht kundrejt NSCC, nënshkruesve dhe palëve të treta. Këto rregullime do të përgatiten e do t'i paraqiten SPRC para se personeli i mbështetur financiarisht t'i atashohet NSCC.

8.9 Mbështetësit financiarë do të sigurojnë që personeli i mbështetur financiarisht të veprojë në çdo kohë në përputhje me procedurat e sigurisë së NSCC. Çdo shkelje e procedurave të sigurisë nga personeli i mbështetur financiarisht gjatë kohës së tij në detyrë do t'i raportohet mbështetësit financiarë për të ndërmarrë masat e përshtatshme sipas politikës aktuale të NATO-s për sigurinë, politikë që i korrespondon rregullimeve në fuqi për sigurinë, kodin e sjelljes, si dhe për garantimin e sigurisë, të nënshkruara me NATO-n dhe/ose të mbështeturin financiarisht.

## Seksioni IX
## **Pajisjet, infrastruktura dhe vlera e mbetur**

9.1 Pasuria me kosto të ndara: çdo pasuri dhe pajisje të blera nga NSCC si një investim i përbashkët përmes buxhetit të përbashkët të NSCC do të bëhet pronë e pjesëmarrësve dhe do të administrohet nga NSCC, duke mbajtur një inventar të të gjithë pasurisë së llogaritshme (regjistri i pasurive).

9.2 Pas mbylljes së NSCC ose përfundimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, tjetërsimi dhe vlera e mbetur e kësaj pasurie në bashkëpronësi do të shlyhet nga SPRC në përputhje me rregullat dhe procedurat e NATO-s e do të jetë në përputhje me nenin IX të Protokollit të Parisit.

9.3 Pasuria e vendit kuadër: Pasuria e blerë nga vendi kuadër, e ndryshme nga pasuria me kosto të ndara, do t'i mbetet vendit kuadër e do të tjetërsohet në pajtim me procedurat e tyre.

9.4 Pasuria e NATO-s: Çdo pajisje e siguruar nga NATO-ja do të mbetet pasuri e NATO-s dhe do të rishpërndahet në përputhje me procedurat standarde të NATO-s dhe me Protokollin e Parisit.

Seksioni X
**Shërbimet mbështetëse**

10.1 Anëtarët e personelit të NSCC, si dhe personat në varësi të tyre do të kenë akses në të gjitha shërbimet mbështetëse të SHAPE në bazë të disponueshmërisë së tyre dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e SHAPE, në masën që lejojnë rregullimet e zbatueshme.

10.2 Anëtarët e personelit të NSCC, si dhe personat në varësi të tyre, duke përfshirë këtu elementin mbështetës kombëtar dhe personat në varësi të tyre, do të sigurojnë kujdesin e tyre mjekësor dhe dentar, strehimin dhe arsimimin e personave në varësi, përveçse kur lejohet ndryshe nga rregullime të tjera të bazuara në marrëveshjet apo rregullimet e zbatueshme dypalëshe apo shumëpalëshe.

10.3 Çdo detyrim për shërbimet dhe lehtësitë e mësipërme do të shprehet dhe faturat apo pagesat do të likuidohen me përfituesit, siç përcaktohet nga SHAPE ose nga elementet që sigurojnë këto shërbime.

Seksioni XI
**Kostot**

11.1 Secili pjesëmarrës do të paguajë për sa më poshtë:

a) Kostot e udhëtimit të personelit të tyre anëtarë të NSCC, që shkaktohen në fillim dhe në fund të turit të kryerjes së detyrës pranë NSCC;

b) Pagat, shpërblimet dhe shpenzimet për dieta për personelin e tyre;

c) Pagesat për udhëtimet e autorizuara sipas rregullave të brendshme kombëtare në lidhje me udhëtimet e përkohshme të punës (si p.sh., shpenzimet për dieta) do të përballohen nga pjesëmarrësi, të cilit i përket personi që po bën udhëtimin e përkohshëm të punës;

d) Çdo pajisje apo personel i sjellë në NSCC nga ky pjesëmarrës mbi sasinë e dhënë nga vendi kuadër;

e) Sistemet e komunikimit dhe informacionit që rrjedhin nga kërkesat e veta të brendshme kombëtare;

f) Çdo kosto shtesë që kërkohet për të plotësuar nevojat e tyre të brendshme kombëtare.

11.2 Në situata rast pas rasti, mund të bëhet edhe aplikim për financim të përbashkët nga NATO-ja nga ana e drejtorit të NSCC përmes Komandës Strategjike përkatëse (SC), drejtuar komiteteve financiare të NATO-s për shqyrtim, në përputhje me politikat dhe rregulloret në fuqi në kohën e aplikimi.

11.3 Kriteret e përzgjedhjes për financime nga NATO-ja për dislokime në mbështetje të operacioneve të miratuara nga NAC përcaktohen me hollësi sipas MC 317 dhe PO (2005)98. Kur përcaktohet si i pranueshëm, financimi për mbështetjen ndaj dislokimeve specifike, si dhe kostot e lidhura me dislokimin specifik, sigurohen përmes SC përkatës e në kontekstin e buxheteve OPLAN (ose shpërndarjeve buxhetore të tyre) të miratuara nga komiteti përkatës financiar.

11.4 Kostot e miratuara të parashikuara në buxhet për NSCC do të paguhen nga pjesëmarrësit në përputhje me seksionin XII të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, siç përcaktohet nga SPRC. Këto kosto mund të përfshijnë (por nuk kufizohen në) komunikimet, mbështetjen në kontrata, kosto për zëvendësimin e ciklit jetësor të pajisjeve të komunikimit, udhëtimet me drejtim për në dhe nga NSCC dhe trajnimet (pa përfshirë dietat), shërbimet publike, qiranë apo përdorimin e ndërtesës, furnizimet, kërkesat e ndryshme për mbështetjen e zyrës, ndryshimet në ndërtesë, riparimet dhe mirëmbajtjen e ndërtesës, hedhjen e mbeturinave, kontrollin e insekteve, si dhe zëvendësimin apo dhënien me qira apo përdorim të pajisjeve të siguruara nga vendi kuadër pas ngritjes. Kostoja shtesë jashtë qëllimit të autoritetit, të parashikuara në buxhetet e miratuara duhet të autorizohen paraprakisht nga SPRC.

11.5 Lidhja me rrjetet e drejtimit dhe kontrollit të NATO-s, komunikimet dhe qarqet e

informacionit, të parashikuara si thelbësore për misionet, do të financohet në përputhje me MC 317 dhe dokumente të tjera përkatëse të NATO-s. NSCC do të përdorë arkitekturën dhe sistemet e komunikimit standard për të garantuar që mbështetja e NSCC me komunikim të shtrihet në të gjitha shtabet, si ato fikse ashtu edhe ato të dislokuara.

11.6 Çdo kosto tjetër e përzier e papërfshirë në kategoritë e mësipërme, por që mund t'i atribuohet operimit të NSCC do të ndahet ndërmjet pjesëmarrësve, në përputhje me seksionin XII të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

11.7 As vendi kuadër, as vendi pritës e as ndonjë nga pjesëmarrësit e tjerë nuk do të nxjerrë të ardhura nga veprimtaritë zyrtare të NSCC.

11.8 Pretendimet dhe pagesat që rrjedhin nga pretendimet që mund t'u atribuohen veprimtarive zyrtare të NSCC do të ndahen ndërmjet pjesëmarrësve, në përputhje me seksionin XII të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

## Seksioni XII
## **Financimi i përbashkët (Buxheti shumëkombësh)**

12.1 Pjesëmarrësit do të financojnë buxhetin shumëkombësh të përbashkët të miratuar të SPRC, në përputhje me numrin e posteve aktuale të pretenduara të secilit pjesëmarrës në NSCC, pjesëtuar me numrin total të posteve të kërkuara nga të gjithë pjesëmarrësit, siç pasqyrohet në shtojcën B.

12.2 Postet e paplotësuara nuk do të ulin pjesën e kostos që duhet të përballojnë pjesëmarrësit e përcaktuar sipas paragrafit 12.1.

12.3 Shtesat e përkohshme (si p.sh., për stërvitje, trajnime etj.) nuk do të prekin pjesët e kostove të pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit që sigurojnë këto shtesa do të përballojnë edhe barrën e kostove përkatëse.

12.4 Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi në lidhje me financimin e përbashkët të buxhetit të NSCC do të hyjnë në fuqi 90 ditë pas aktivizimit të NSCC, si një IMHQ nga NAC. Vendi kuadër (FN) është përgjegjës për lehtësimin e zbatimit të NSCC për sigurimin fillestar të burimeve njerëzore, financimin dhe mbështetjen e NSCC derisa ky Memorandum Mirëkuptimi të hyjë në fuqi.

## Seksioni XIII
## **Pretendimet**

13.1 Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Memorandumi Mirëkuptimi, pretendimet do të zgjidhen në përputhje me nenin VIII të NATO SOFA dhe nenin VI të Protokollit të Parisit.

## Seksioni XIV
## **Procedurat financiare**

14.1 Fondet e dhëna nga pjesëmarrësit dhe procedurat financiare do të jenë në përputhje me rregulloret aktuale financiare të NATO-s dhe me rregullat dhe procedurat zbatuese, siç do të përcaktohet se do jetë e zbatueshme dhe e mundur nga SPRC.

14.2 Fondet e vëna në dispozicion nga burimet e NATO-s do të kërkohen dhe përllogariten në përputhje me procedurat standarde të NATO-s, të përcaktuara në direktivat ACO ose siç udhëzohet nga Kontrollori Financiar i ACO.

14.3 Viti fiskal fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

14.4 Projektbuxheti që tregon shpenzimet e llogaritura do të përgatitet në euro dhe do t'i dërgohet SPRC nga drejtori i NSCC në datën e përcaktuar nga SPRC çdo vit për vitin fiskal pasardhës. Në të njëjtën kohë, drejtori i NSCC do të sigurojë, gjithashtu, një plan financiar afatmesëm për pesë vitet që do të vijnë pas vitit fiskal pasardhës, për qëllime planifikimi. Projektbuxheti do të shqyrtohet nga SPRC dhe do të miratohet përpara vitit financiar pasardhës. Në qoftë se gjatë vitit fiskal ndodh që fondet buxhetore të miratuara nuk janë të mjaftueshme, drejtori i NSCC mund të paraqesë një buxhet shtesë për shqyrtim nga SPRC.

14.5 Në përputhje me buxhetin e miratuar, drejtori i NSCC normalisht do të paraqesë një kërkesë për fonde (CFF) çdo vit, të pagueshme nga pjesëmarrësit në përputhje me kushtet e

përcaktuara nga SPRC. Çdo kredi që do të jetë detyrim ndaj pjesëmarrësve do të balancohet në CFF përkatëse. Pagesat do të jenë pa taksa apo tatime e do të bëhen në euro në llogarinë bankare të dhënë nga drejtori i NSCC. Nëse më vonë miratohet një buxhet shtesë nga SPRC, mund të lëshohet edhe një CFF e dytë.

14.6 Drejtori i NSCC do t'i paraqesë SPRC një deklaratë përfundimtare të llogarive deri më 31 mars të vitit pasardhës. Deklarata e llogarive përfundimtare do t'i paraqitet SPRC për miratim.

14.7 Agjencia e parapëlqyer për auditim është Bordi Ndërkombëtar i Auditëve për NATO-n (IBAN). Megjithatë, auditimet do të bëhen siç do të autorizohet nga SPRC.

14.8 Përgjegjësia financiare e pjesëmarrësve sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi i nënshtrohet autorizimit dhe përvetësimit të fondeve në përputhje me ligjet e tyre të brendshme kombëtare.

14.9 Pjesëmarrësit kanë të drejtën e aksesit në të gjithë informacionin e nevojshëm mbi kontributin e tyre ndaj financimeve të përbashkëta të NSCC për qëllime auditimi.

## Seksioni XV
## **Sigurimi dhe mbrojtja e forcave**

15.1 Sigurimi i jashtëm dhe mbrojtja e forcave do të sigurohet nga vendi pritës ose nga vendi kuadër, në përputhje me rregulloret e infrastrukturës së vendosjes së NSCC.

15.2 Sigurimi i brendshëm është përgjegjësi e drejtorit të NSCC, duke vepruar në përputhje me rregullat e zbatueshme të sigurisë. Kostot e sigurisë janë të pranueshme sipas financimit të përbashkët (të tilla, si p.sh., kostoja e rojeve me shërbim 24-orësh).

15.3 Pjesëmarrësit do të garantojnë sigurinë e të gjithë informacionit të klasifikuar në përputhje me rregullat dhe rregulloret e sigurisë, jo më pak rrepta sesa ato që parashikohen për informacionin e klasifikuar të NATO-s në dokumentin CM (2002) 49, duke përfshirë dhe të gjitha shtesat dhe ndryshimet ndaj këtij dokumenti e në përputhje me marrëveshjet dhe rregulloret e zbatueshme.

15.4 Dispozita të mëtejshme do të përcaktohen në Marrëveshjen Teknike, siç përmendet në seksionin III, paragrafi 3.2.

15.5 Anëtarët e personelit të NSCC do të veprojnë në përputhje me kërkesat për autorizime të sigurisë në përputhje me përshkrimet e punës së NSCC.

15.6 Secili pjesëmarrës do të sigurojë që anëtarët e personelit të NSCC të veprojnë në çdo kohë në përputhje me procedurat e sigurisë së NSCC. Çdo shkelje e procedurave të sigurisë nga anëtarët e personelit të NSCC gjatë kohës së qëndrimit të tyre në detyrë do t'i raportohet pjesëmarrësit përkatës për të marrë masat e duhura sipas dokumenteve CM (2002) 49, AC / 35 - D/2002 dhe AD 65 - 3.

## Seksioni XVI
## **Komiteti i Lartë i Politikave dhe Burimeve**

16.1 Përfaqësuesit e përcaktuar të nënshkruesve do të përbëjnë Komitetin e Lartë të Politikave dhe Burimeve (SPRC), i cili do të funksionojë në përputhje me termat e referencës të përcaktuar në shtojcën C. Pjesëmarrësit do të sigurojnë përfaqësimin e tyre në takimet e SPRC me autoritetin e duhur për të diskutuar dhe marrë vendime mbi politikat, burimet njerëzore dhe/ose çështje financiare si të jetë e nevojshme, bazuar në programin e secilit takim. SPRC do të kryesohet nga vendi kuadër dhe do të zhvillojë takime të paktën një herë në vit për të miratuar buxhetin e përbashkët, për të shtruar për zgjidhje çështje të plotësimit me burime njerëzore, si dhe çdo çështje tjetër në lidhje me politikat apo çështje financiare. Secili nënshkrues do të ketë një votë dhe të gjitha votat duhet të jenë unanime dhe të mos përfshijnë procedura heshtjeje. Çdo ndryshim në aspektet financiare të shtojcave B, E dhe F duhet të marrë miratimin e SPRC.

## Seksioni XVII
## **Mosmarrëveshjet**

17.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet vetëm përmes konsulencës ndërmjet nënshkruesve. Mosmarrëveshjet që lidhen me këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do t'i referohen për zgjidhje asnjë pale të tretë.

Seksioni XVIII

**Hyrja në fuqi, tërheqja, kohëzgjatja, amendimi, pjesëmarrja dhe përfundimi**

18.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e fundit të nënshkrimit të vendit kuadër, vendit pritës dhe SHAPE, si dhe në lidhje me të gjithë pjesëmarrësit e tjerë, në datën e nënshkrimit të secilit prej këtyre pjesëmarrësve.

18.2 Nëse NAC do të miratojë NSCC si pjesë të NCS, pjesëmarrësit do të hyjnë në kështillime të menjëhershme për të zbatuar vendimin e NAC për periudhën e përkohshme me përkushtimin e vendosur për të mos e tërhequr NSCC nga kapaciteti i saj operacional gjatë kësaj periudhe të përkohshme.

18.3 Nëse ndryshime të ardhshme në zonën gjeografike të shtabit të NATO-s prekin vendndodhjen e SHAPE dhe eventualisht edhe vendndodhjen e NSCC, nënshkruesit do të hyjnë në kështillime të menjëhershme në lidhje me pasojat e këtyre ndryshimeve mbi dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

18.4 Çdo nënshkrues që dëshiron të tërhiqet nga ky Memorandum Mirëkuptimi do të japë një njoftim me shkrim 12 muaj përpara ndaj të gjithë nënshkruesve të tjerë. Në këtë rast, pjesëmarrësit që mbeten do të takohen e do të diskutojnë për rishpërndarjen e kostove të përbashkëta, financimet dhe vendet e paplotësuara.

18.5 Nëse një pjesëmarrës do të tërhiqet nga ky Memorandum Mirëkuptimi dhe nëse pjesa e tij nuk merret përsipër nga ndonjë pjesëmarrës tjetër, ai:

a) Do të vazhdojë të mbështesë NSCC deri në fund të periudhës së njoftimit, duke përfshirë pagimin e pjesës së tij të buxhetit të përbashkët deri në fund të vitit fiskal, në të cilin mbaron periudha e njoftimit.

b) Do të rimbursohet për vlerën e mbetur të të gjitha investimeve, në të cilat ai ka kontribuar në masën që pjesa e tij merret përsipër nga një pjesëmarrës tjetër, siç është rënë dakord nga pjesëmarrësit e përfshirë drejtpërdrejt. Nëse pjesëmarrësi që tërhiqet nuk rimbursohet në kohën e tërheqjes, ai do ta ruajë pretendimin e tij për vlerën e mbetur deri në kohën që një pjesëmarrës tjetër merr përsipër pjesën e tij dhe paguan dëmshpërblimin për to ose derisa investimet të jenë zhvleftësuar plotësisht.

18.6 Çdo nënshkrues i këtij Memorandumi Mirëkuptimi mund të propozojë shtesa ndaj dispozitave të tij. Gjatë procesit të ndryshimit ose miratimit të shtesave apo rishikimeve, nënshkruesit do të vazhdojnë të përmbushin përgjegjësitë e tyre sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

a) Çdo ndryshim në këtë Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi kur të jetë pranuar me shkrim nga të gjithë nënshkruesit e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

b) Ndryshimet ndaj shtojcave B, E dhe F të këtij Memorandumi Mirëkuptimi kërkojnë vetëm miratimin e SPRC.

18.7 Pjesëmarrja në Memorandumin e Mirëkuptimit të NSCC është e hapur ndaj cilitdo anëtar të NATO-s pas pranimit nga ana e tij të kushteve të arsyeshme dhe të barabarta, të përcaktuara nga pjesëmarrësit. Aplikimet për të marrë pjesë në këtë Memorandum Mirëkuptimi mund të bëhen në çdo kohë. Secili aplikim i ri do t'i rekomandohet nënshkruesve nga SPRC. Vendeve aplikuese që kërkojnë t'i bashkohen këtij Memorandumi Mirëkuptimi mund t'u vendoset një tarifë fillestare e hyrjes e caktuar nga SPRC, me qëllim që vendit hyrës t'i mundësohet që të ndajë në çfarëdo vlere të mbetur nëse NSCC mbyllet dhe/ose futet nën strukturën e komandës së NATO-s.

a) Kontributi i plotë i secilit vend aplikues do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe negocimit nga ana e SPRC. Kontributi financiar do të jetë në përputhje me parimet e ndarjes së kostove të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

b) Një notë e anëtarësimit do të përfundohet ndërmjet vendit aplikues dhe nënshkruesve të këtij Memorandumi Mirëkuptimi në SPRC. Nota e anëtarësimit do të regjistrojë faktin që një vend aplikues është bërë pjesëmarrës në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

c) Statusi si pjesëmarrës do të jetë në fuqi që nga data e nënshkrimit të fundit në notën e anëtarësimit (të përmendur më lart në paragrafin 18.5.b) që pasqyron këtë anëtarësim, përveçse kur bihet dakord ndryshe nga nënshkruesit.

18.8 Nëse vendi kuadër apo SHAPE jep njoftim për qëllimin e tij për t'u tërhequr nga ky Memorandum Mirëkuptimi, në përputhje me seksionin 18.2 më lart, ky Memorandum Mirëkuptimi do të përfundojë 12 muaj pas dhënies së njoftimit fillestar mbi tërheqjen.

18.9 Në rastin e përfundimit apo tërheqjes nga ky Memorandum Mirëkuptimi, nënshkruesit do të sigurojnë që dispozitat që lidhen me sigurinë, përhapjen e informacionit të klasifikuar, konfidencialitetin dhe çështjet dhe detyrimet financiare do të mbeten në fuqi.

18.10 Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të përfundojë në çdo kohë me pëlqimin unanim të nënshkruesve.

Sa më lart përfaqëson mirëkuptimet e arritura ndërmjet nënshkruesve mbi çështjet e përmendura në të.

Ky Memorandum Mirëkuptimi u shkrua dhe u nënshkrua vetëm në gjuhën angleze dhe versioni anglisht i tij është ai zyrtar. Origjinali do të depozitohet pranë Komandës Aleate të Operacioneve, e cila do të përcjellë një kopje të vërtetuar për nënshkruesit dhe për NSCC.

Për Ministrin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Belgjikës
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Belgjikës

Për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Bullgarisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Bullgarisë

Për Departamentin e Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Kanadasë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Çekisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Republikës Çeke

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Danimarkës
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Mbretërisë së Danimarkës

Për Ministrin e Mbrojtjes të Republikës Franceze
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Francës

Për Ministrinë Federale të Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Gjermanisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Greqisë

Shënim. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Parlamenti.

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Hungarisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Hungarisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Italiane
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Italisë

Shënim. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit (me anë të notës verbale), me anë të të cilës Italia do të informojë palët e tjera se procedurat e parashikuara nga ratifikimi janë përmbushur.

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Letonisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Letonisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Lituanisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Lituanisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Holandës
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Holandës

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Norvegjisë

Për Ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Polonisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Polonisë

Për Ministrin e Mbrojtjes së Republikës Portugeze
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Portugalisë

Për Ministrisë Rumune të Mbrojtjes Kombëtare
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Rumanisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Sllovake
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Sllovakisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Sllovenisë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Spanjës
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Spanjës

Për Shtabin e Përgjithshëm të Republikës së Turqisë
_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Turqisë

Shënim. Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, çdo shtesë ndaj tij dhe dispozitat që lidhen me pjesëmarrjen e ardhshme do të hyjnë në fuqi pas njoftimit nga ana e Turqisë se i gjithë procesi i brendshëm i ratifikimit është përmbushur.

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

_____datë_____
Përfaqësuesi Kombëtar Ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar

Për Departamentin e Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës
_____datë_____
Titulli

Për Shtabin Suprem të Fuqive Aleate për Europën (SHAPE)
_____datë_____
Shef Shtabi

SHTOJCA A
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC
PËRGJEGJËSITË E VENDIT KUADËR

1.1 Sipas disponueshmërisë së fondeve për këto qëllime, vendi kuadër do të jetë përgjegjës për

artikujt që vijojnë në lidhje me bashkërendimin dhe lehtësimin e vendimeve në lidhje me NSC.

a) Sigurimin e fondeve për ngritjen e përhershme të NSCC. Ngritja përkufizohet si sigurim i mjediseve për të paktën 150 anëtarë të personelit dhe infrastrukturës e pajisjeve të mjaftueshme të lidhura me të për të kryer misionin e tyre operacional. Pas kësaj ngritjeje, kostot operacionale të lidhura me mjediset, zëvendësimi i pajisjeve kapitale, përfshirë këtu pagimin e qirave, do të jenë përgjegjësi e buxhetit të përbashkët siç do të përcaktohet nga SPRC.

b) Mbështetjen e bashkërendimit të përgjithshëm, lehtësimit dhe zbatimit të vendimeve të SACEUR në lidhje me NSCC.

c) Mundësimin e zbatimit për burimet njerëzore, financimin dhe mbështetjen e NSCC derisa të hyjë në fuqi seksioni XII, paragrafi 12.4 i këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

d) Drejtimi i përmbushjes së çështjeve administrative të tilla si administrimi i personelit, furnizimet, shërbimet dhe çështje të tjera që nuk janë të përfshira në misionet operacionale të ngarkuara nga SACEUR.

e) Rregullimi, bashkërendimi dhe lehtësimi i mbështetjes së kërkuar për NSCC siç pasqyrohet në buxhetin e miratuar shumëkombësh të NSCC mbi një bazë të rimbursueshme. Kostot do të ndahen në përputhje me seksionin XII të Memorandumit të Mirëkuptimit.

f) Rregullimi i shërbimeve të kontrollorit financiar përmes një auditi ekzistues në shtabin e NATO-s, ose një rregullim tjetër i pranueshëm.

g) Vënia në dispozicion e kryetarit dhe sekretarit të takimeve të SPRC.

h) Informimi dhe kërkimi i miratimit të pjesëmarrësve për të gjitha veprimet/negociatat e ndërmarra në emër të tyre në lidhje me buxhetin e përbashkët.

i) Sigurimi fondeve për një personel të caktuar fillestar logjistik dhe mbështetës jashtë atyre të parashikuara në dokumentin e Memorandumit të Mirëkuptimit për burimet njerëzore. Vendi kuadër do të financojë këtë personel derisa të hyjë në fuqi buxheti i përbashkët, kohë në të cilën pjesëmarrësit (përmes SPRC) do të përcaktojnë se cilat pozicione logjistike dhe mbështetëse jashtë atyre të parashikuara në dokumentin e Memorandumit të Mirëkuptimit për burimet njerëzore, do të financohen nga buxheti i përbashkët.

SHTOJCA B
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC

STRUKTURA DHE PROCEDURAT PËR SIGURIMIN E BURIMEVE NJERËZORE PËR NSCC-NË

Parimet

1.1 Nivelet e burimeve njerëzore të NSCC do të rishikohen vazhdimisht dhe do të përshtaten mbi bazën e vlerësimit të kërkesave të misionit dhe numrit të personelit të vënë në dispozicion nga pjesëmarrësit.

1.2 SPRC do të miratojë bashkërisht të gjitha ofertat fillestare të pjesëmarrësve për të shtuar pjesën e tyre të posteve ose rekomandimet për përshkrime pune të reja apo të ndryshuara. Në takimin e tyre të parë, SPRC do të miratojë grupin e parë të përshkrimeve të punës të NSCC.

1.3 Personeli i zgjedhur për t'u emëruar në NSCC duhet të përmbushë kërkesat e përshkrimeve të punës.

1.4 Të gjithë anëtarët e personelit të NSCC do të jenë të pranueshëm për dislokim dhe për detyra të përkohshme në përputhje me përshkrimin e tyre të punës, sipas ligjeve dhe rregulloreve të tyre kombëtare dhe pas miratimit të NMR ose SNR përkatës në emër të pjesëmarrësit.

Organizimi

2.1 Organizimi i NSCC do të jetë shumëkombësh dhe i përbashkët në përputhje me dokumentin e NATO-s IMSM – 0856 – 2006 dhe fillimisht do të drejtohet nga një oficer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2.2 Organizimi fillestar dhe niveli i burimeve njerëzore të NSCC përshkruhet më poshtë. Struktura dhe nivelet e burimeve njerëzore janë vetëm një vlerësim fillestar dhe i nënshtrohen ndryshimeve në përputhje me procedurat e përshkruara më lart.

2.3 Secili post individual i tabelës së burimeve njerëzore të Memorandumit të Mirëkuptimit për NSCC (bashkëlidhja 2 e shtojcës B) do të jepet hollësisht në një përshkrim pune (JD).

BASHKËLIDHJE 1 E SHTOJCËS B
MBI MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT PËR NSCC

Diagrami i lidhjes së organizimit dhe burimeve njerëzore sipas Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU) për NSCC
(sipas Konferencës së datës 8 maj 2008 të MoU)

Kërkesat aktuale të planifikuara për burime njerëzore: Totali 149

<table>
<tr><td colspan="3"></td><td colspan="3">Drejtori<br>(2 persona)</td><td colspan="3"></td></tr>
<tr><td colspan="3"></td><td colspan="3">Nëndrejtori<br>(2 persona)</td><td colspan="3"></td></tr>
<tr><td colspan="3">Personel i posaçëm<br>(16 persona)</td><td colspan="3">Shefi i Shtabit<br>(3 persona)</td><td colspan="3"></td></tr>
<tr><td colspan="3"></td><td colspan="3"></td><td colspan="3"></td></tr>
<tr><td colspan="3">DCoS për mbështetjen<br>(3 persona)<br>(43 në total)</td><td colspan="3">DCoS për operacionet<br>(3 persona)<br>(47 në total)</td><td colspan="3">DCoS për trajnimin dhe gatishmërinë<br>(3 persona)<br>(36 në total)</td></tr>
<tr><td>J1<br>(9 persona)</td><td>J4<br>(3 persona)<br>(14 në total)</td><td>J6<br>(4 persona)<br>(17 në total)</td><td>J2<br>(7 persona)</td><td>J3<br>(6 persona)<br>(22 në total)</td><td>J5<br>(3 persona)<br>(15 në total)</td><td>J7<br>(2 persona)<br>(17 në total)</td><td>Qendrat dhe vlerësimet për SOF<br>(10 persona)</td><td>Doktrina dhe standardet<br>(6 persona)</td></tr>
<tr><td></td><td>Xhenio<br>(2 persona)</td><td>Planet<br>(7 persona)</td><td></td><td>Planet<br>(8 persona)</td><td>Politikat<br>(3 persona)</td><td>Trajnimi dhe arsimimi<br>(9 persona)</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Planet<br>(7 persona)</td><td>Menaxhim i njohurive<br>(3 persona)</td><td></td><td>Kundërpërgjigja ndaj krizave<br>(5 persona)</td><td>Konceptet e së ardhmes<br>(3 persona)</td><td>Stërvitjet<br>(6 persona)</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Kujdesi mjekësor<br>(2 persona)</td><td>Blerjet dhe ndërvepruesmëria<br>(3 persona)</td><td></td><td>Gjenerimi i forcës<br>(3 persona)</td><td>Planifikimi strategjik<br>(3 persona)</td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>LNO<br>0</td><td>Kërkesat dhe kapacitetet<br>(3 persona)</td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

BASHKËLIDHJE 2 E SHTOJCËS B
MBI MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT PËR NSCC

| Numri i postit | Pozicioni i detyrës | Grada | Vendi | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|
| | Zyra e drejtorit | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| OSO GXX 0010 | Drejtor i NSCC | OF7 / OF8 | USA | |
| OSO GXX 0020 | Drejtues i lartë i thjeshtë | OR9 | ITA (Itali) | |
| | Zyra e nëndrejtorit | | | |
| OSO GXD 0010 | Nëndrejtori | OF6 | GBR (Mbretëria e Bashkuar) | |
| OSO GXD 0020 | Oficeri për koordinimin | OF 3/4 | LTU (Lituania) | |
| | Shefi i shtabit | | | |
| OSO GXC 0010 | Shefi i shtabit | OF5 | USA | |
| OSO GXX 0030 | Oficeri ekzekutiv | OF4 | USA | |
| OSO GXX 0040 | Asistent ekzekutiv i komandës | OF3 | USA | |
| | Personeli i posaçëm | | | |
| OSO GXS 0010 | LEGAD | OF4 | NOR (Norvegjia) | |
| OSO GXS 0020 | Oficer për marrëdhëniet me publikun | OF4 | USA | |
| OSO GXS 0030 | Asistenti PA | OF3 | USA | |
| OSO GXS 0040 | NCOIC administrativ | OR8 | GBR | |
| OSO GXS 0050 | Asistent administrativ | OR6 | USA | |
| OSO GXS 0160 | Asistent administrativ | OR7 | USA | |
| OSO GXS 0060 | Drejtues i seksionit të buxhetit dhe prokurimeve | OF4 | USA | |
| OSO GXS 0070 | Hartimi i buxhetit | OF2 / OF3 | USA | |
| OSO GXS 0080 | Oficer shtabi për prokurimet | OF2 / OF3 | USA | |
| OSO GXS 0090 | Asistent për blerjet | OR7 | USA | |
| OSO GXS 0100 | Drejtues i seksionit të elementit mbështetës | OF2 | USA | |
| OSO GXS 0110 | Mbikëqyrës i elementit mbështetës | OR8 | USA | |
| OSO GXS 0120 | Shef i furnizimit të elementit mbështetës | OR7 | USA | |
| OSO GXS 0130 | Asistent i logjistikës së elementit mbështetës | OR7 | USA | |
| OSO GXS 0140 | Administrues i sigurisë | OF3 | USA | |
| OSO GXS 0150 | Administrues i sigurisë NCOIC | OR7 | FRA (Franca) | |
| Numri i postit | Pozicioni i detyrës | Grada | Vendi | Shënime |
| | | | | |
| OSO GSX 0010 | Mbështetja e DCoS | OF5 | DEU (Gjermani) | |
| OSO GXS 0020 | Oficer i koordinimit | OF2 / OF3 | | |
| OSO GXS 0030 | Asistent ekzekutiv | OR6 | DEU | |
| | J1 – Burimet njerëzore | | | |
| OSO HXX 0010 | Drejtori i burimeve njerëzore | OF5 | USA | |
| OSO HXX 0020 | Burimet njerëzore NCOIC | OR7 | BEL (Belgjikë) | |
| OSO HXX 0030 | NCOIC administrativ | OR6 | | |
| OSO HXX 0040 | Planifikues i lartë për programet mbi burimet njerëzore dhe gatishmërinë | OF4 | | |
| OSO HXX 0050 | Oficer për menaxhimin e burimeve njerëzore | OF3 | USA | |
| OSO HXX 0060 | Oficer për planet mbi personelin | OF3 | USA | |
| OSO HXX 0070 | Nënoficer për burimet njerëzore | OR6 | GBR | |
| OSO HXX 0080 | Nënoficer për burimet njerëzore | OR6 | DEU | |
| OSO HXX 0090 | Nënoficer për burimet njerëzore | OR5 | USA | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | J4 – Logjistika | | | |
| OSO LXX 0010 | Drejtori i logjistikës | OF5 | ITA | |
| OSO LXX 0020 | Nëndrejtor i logjistikës | OF 3/4 | GBR | |
| OSO LXX 0030 | Asistent administrativ | OR6 | ESP (Spanjë) | |
| | Personel i xhenios | | | |
| OSO LEX 0010 | Drejtues i seksionit të xhenios | OF4 | USA | |
| OSO LEX 0020 | Planifikues i xhenios | OF3 | USA | |
| | Personeli i planifikimit logjistik | | | |
| OSO LPX 0010 | Drejtues i degës së planifikimit logjistik | OF5 | POL (Poloni) | |
| OSO LPX 0020 | Planifikues logjistik | OF4 | GBR | |
| OSO LPX 0030 | Planifikues logjistik | OF3 | USA | |
| OSO LPX 0040 | Planifikues logjistik | OF2 / OF3 | FRA | AJRORE |
| OSO LPX 0050 | Planifikues logjistik | OF2 / OF3 | USA | |
| OSO LPX 0060 | Planifikues logjistik | OR5 | GBR | |
| OSO LPX 0070 | Oficer i transportit dhe lëvizjeve | OF2 / OF3 | USA | |
| | Personel mjekësor | | | |
| OSO LMX 0010 | Oficer i lartë mjekësor/ Këshilltar mjekësor | OF3 / OF4 | USA | |
| OSO LMX 0020 | Oficer i planifikimit mjekësor | OF3 | USA | |
| Numri i postit | Pozicioni i detyrës | Grada | Vendi | Vërejtje |
| | J6 – Komunikimet | | | |
| OSO CXX 0010 | Drejtor i komunikimeve | OF 4 / 5 | GBR | |
| OSO CXX 0020 | Komunikimet, NCOIC | OR8 | GBR | |
| OSO CXX 0030 | Asistent administrativ | OR6 | NOR | |
| OSO CXX 0040 | Planifikues i lartë i programeve të komunikimit dhe gatishmërisë | OF4 | USA | |
| | Plani i komunikimeve | | | |
| OSO CPX 0010 | Drejtues i degës së planifikimit dhe politikave | OF 3/4 | ESP | |
| OSO CPX 0020 | Planet dhe politikat | OF3 | USA | |
| OSO CPX 0030 | Planet dhe politikat | OR7 / OR8 | DEU | |
| OSO CPX 0040 | Inxhinier rrjeti | OF3 | ROU (Rumani) | |
| OSO CPX 0050 | Teknik i sigurisë së informacionit | OF3 | USA | |
| OSO CPX 0060 | Teknik i sigurisë së informacionit | OR7 | CAN (Kanada) | |
| OSO CPX 0070 | Administrues i frekuencave | OR7 | FRA | |
| | Menaxhim i njohurive | | | |
| OSO CPN 0010 | Drejtues i degës së menaxhimit të njohurive | OF3 | USA | |
| OSO CPN 0020 | Menaxhim i njohurive | OF3 | USA | |
| OSO CPN 0030 | Menaxhim i njohurive | OF3 | USA | |
| | Blerjet dhe ndërveprueshmëria | | | |
| OSO CMR 0010 | Drejtues i degës së prokurimeve dhe ndërveprimit të ndërlidhjes | OF3 | USA | |
| OSO CMR 0020 | Teknik për ndërveprimin e ndërlidhjes | OF 2/3 | USA | |
| OSO CMR 0030 | Oficer për prokurimet dhe kërkesat e CIS | OF3 | USA | |
| | | | | |
| OSO GOX 0010 | Operacionet e DCoS | OF5 | NOR / FRA | (ROT) (me rotacion) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| OSO GOX 0020 | Oficer i koordinimit | OF2 / OF3 | DEU | |
| OSO GOX 0030 | Asistent ekzekutiv | OR6 | NLD (Holandë) | |
| | J2 – Inteligjenca (zbulimi) | | | |
| OSO IXX 0010 | Drejtor i zbulimit | OF4 | GBR | |
| OSO IXX 0020 | Koordinues i zbulimit | OF3 / OF4 | USA | |
| OSO IXX 0030 | Koordinues i zbulimit | OF3 / OF4 | DEU | |
| OSO IXX 0040 | Koordinues i zbulimit | OF 3/4 | ESP | |
| OSO IXX 0050 | Koordinues i zbulimit | OF 3/4 | SVK (Sllovakia) | |
| OSO IXX 0060 | Koordinues i zbulimit | OF3 | USA | |
| OSO IXX 0070 | Oficer i zbulimit/NCO | OF3 | POL | |
| Numri i postit | Pozicioni i detyrës | Grada | Vendi | Vërejtje |
| | J3 – operacionet | | | |
| OSO OXX 0010 | Drejtor i operacioneve | OF5 | FRA/NOR | (ROT) (me rotacion) |
| OSO OXX 0020 | Nëndrejtor i operacioneve | OF4 | USA | |
| OSO OXX 0030 | Nënoficer për operacionet | WO4 / WO5 | USA | |
| OSO OXX 0040 | Nënoficer për operacionet | OR 8/9 | GBR | |
| OSO OXX 0050 | NCOIC administrativ | OR8 | TUR (Turqia) | |
| OSO OXX 0060 | Asistent administrativ | OR6 | HUN (Hungaria) | |
| | Planet operacionale | | | |
| OSO OCJ 0010 | Drejtues i degës së planeve operacionale | OF4 | ESP | |
| OSO OCJ 0020 | Planifikues i lartë i operacioneve | OF3 / OF4 | USA | |
| OSO OCJ 0030 | Planifikues i operacioneve tokësore | OF2 / OF3 | FRA | |
| OSO OCJ 0040 | Planifikues i operacioneve tokësore | OR9 | USA | |
| OSO OCJ 0050 | Planifikues i operacioneve ajrore | OF3 | USA | |
| OSO OCJ 0060 | Planifikues i operacioneve ajrore | OF2 / OF3 | TUR | |
| OSO OCJ 0070 | Planifikues i operacioneve detare | OF2 / OF3 | GRC (Greqia) | |
| OSO OCJ 0080 | Planifikues i operacioneve detare | OF2 / OF3 | ITA | |
| | Kundërpërgjigja ndaj krizave | | | |
| OSO OCX 0010 | Drejtues i degës për kundërpërgjigjen ndaj krizave | OF4 | NLD | |
| OSO OCX 0020 | Planifikues i operacioneve detare | OF3 | USA | |
| OSO OCX 0030 | Planifikues i operacioneve tokësore | OF3 | CZE (Republika Çeke) | |
| OSO OCX 0040 | Planifikues i operacioneve tokësore | OF3 / OF4 | USA | |
| OSO OCX 0050 | Planifikues i operacioneve ajrore | OF3 / OF4 | ITA | |
| | Gjenerimi i forcës | | | |
| OSO OCG 0010 | Drejtues i degës së gjenerimit të forcës | OF4 | NOR | |
| OSO OCG 0020 | Planifikues i operacioneve | OF3 / OF4 | ITA | |
| OSO OCG 0030 | Gjenerimi i forcës NCO | OR9 | POL | |
| | LNO | | | |
| OSO OXL 0010 | Oficer ndërlidhës | OF 3/4 | | |
| OSO OXL 0020 | Oficer ndërlidhës | OF 3/4 | | TBD |
| OSO OXL 0030 | Oficer ndërlidhës | OF 3/4 | | (për t'u |
| OSO OXL 0040 | Oficer ndërlidhës | OF 3/4 | | vendosur) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| OSO OXL 0050 | Oficer ndërlidhës | OF 3/4 | | |
| OSO OXL 0060 | Oficer ndërlidhës | OF 3/4 | | |
| Numri i postit | Pozicioni i detyrës | Grada | Vendi | Vërejtje |
| | J5 – Planifikimi dhe politikat | | | |
| OSO PXX 0010 | Drejtori i planifikimit dhe politikave | OF5 | ESP | |
| OSO PXX 0020 | Nëndrejtori i planifikimit dhe politikave | OF4 | USA | |
| OSO PXX 0030 | Asistent administrativ | OR6 | ITA | |
| | Politikat | | | |
| OSO PPX 0010 | Drejtues i degës së SOF | OF4 | TUR | |
| OSO PPX 0015 | Hartues i politikave të SOF | OF4 | DEU | |
| OSO PPX 0020 | Hartues i politikave të SOF | OF3 | DNK (Danimarkë) | |
| | Konceptet e së ardhmes | | | |
| OSO PFX 0010 | Drejtues i degës mbi konceptet e së ardhmes | OF4 | CZE / FRA * | * CZE deri në 2011, më pas FRA. Edhe CZE edhe FRA kanë VNC në këtë degë. |
| OSO PFX 0020 | Planifikues mbi konceptet e së ardhmes | OF4 | CAn | |
| OSO PFX 0030 | Planifikues mbi konceptet e së ardhmes | OF3 | CZE | |
| | Planet strategjike | | | |
| OSO PLX 0010 | Drejtues i degës mbi strategjinë e SOF | OF4 | USA | |
| OSO PLX 0020 | Hartues i strategjisë së SOF | OF4 | ESP | |
| OSO PLX 0030 | Hartues i strategjisë së SOF | OF3/4 | GBR | |
| | Kapaciteti dhe kërkesat | | | |
| OSO PCX 0010 | Drejtues i degës mbi kapacitetin dhe kërkesat | OF4 | NLD | |
| OSO PCX 0020 | Planifikues i SOF | OF 3/4 | POL | |
| OSO PCX 0030 | Planifikues i SOF | OF 3/4 | ITA | |
| | | | | |
| OSO GTX 0010 | Trajnimi dhe gatishmëria e DCoS | OF5 | ITA | |
| OSO GTX 0020 | Oficeri i koordinimit | OF2 / OF3 | ITA | |
| OSO GTX 0040 | NCOIC administrativ | OR8 | FRA | |
| | J7 | | | |
| OSO GTA 0010 | Drejtor i trajnimit, arsimimit dhe stërvitjes | OF4 | USA | |
| OSO GTA 0030 | Administrata NCOIC | OR6 | GRC | |
| Numri i postit | Pozicioni i detyrës | Grada | Vendi | Vërejtje |
| | Trajnimi dhe arsimimi | | | |
| OSO GTT 0010 | Drejtues i degës së trajnimit dhe arsimimit | OF4 | DEU | |
| OSO GTT 0020 | Zëvendës drejtuesi i degës së trajnimit dhe arsimimit | OF4 | ESP | |
| OSO GTT 0030 | Planifikues dhe instruktor trajnimi (tokësor) | OF3/4 | PRT (Portugali) | |
| OSO GTT 0040 | Planifikues dhe instruktor trajnimi (ajror) | OF3 | USA | |
| OSO GTT 0050 | Planifikues dhe instruktor trajnimi (detar) | OF3 | DEU | |
| OSO GTT 0060 | Planifikues dhe instruktor trajnimi (zbulimi) | OF3 | BUL (Bullgari) | |
| OSO GTT 0070 | Planifikues dhe instruktor trajnimi | OF3 | NOR | |
| OSO GTT 0080 | Planifikues dhe instruktor trajnimi | OR8 | SVN (Slloveni) | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| OSO GTT 0090 | Planifikues dhe instruktor trajnimi | OR8 | USA | |
| | Stërvitja | | | |
| OSO GTE 0010 | Drejtues i degës së stërvitjes | OF4 | ROU | |
| OSO GTE 0020 | Stërvitja strategjike | OF3 | USA | |
| OSO GTE 0040 | Planifikues i operacioneve | OF3 | LTU | |
| OSO GTE 0050 | Planifikues i operacioneve | OF3 | USA | |
| OSO GTE 0060 | Planifikues i operacioneve | OF3 | TUR | |
| OSO GTX 0050 | Asistent administrativ | OR6 | ESP | |
| | Qendrat SOF, vlerësimet dhe kontrollet | | | |
| OSO GTS 0010 | Drejtues i degës për qendrat SOF, vlerësimet dhe kontrollet | OF4 | HUN | HUN-ja do të plotësojë vendin deri në korrik 2010 e më pas USA |
| OSO GTS 0020 | Zëvendësdrejtues i degës | OF3/4 | ESP | ESP-ja do të plotësojë vendin deri në korrik 2010 e më pas HUN |
| OSO GTS 0030 | Koordinator i qendrës SOF | OF3/4 | USA | |
| OSO GTD 0020 | Asistent administrativ | OR7 | NLD | |
| OSO GTD 0050 | Koordinator i zhvillimit të trajnimeve të SOF | OF7 | GBR | Ajror |
| OSO GTD 0060 | Koordinator i zhvillimit të trajnimeve të SOF | OF3/4 | BEL (Belgjikë) | |
| OSO GTD 0070 | Koordinator i zhvillimit të trajnimeve të SOF | OF2/3 | LAT (Letoni) | |
| OSO GTE 0030 | Koordinator i zhvillimit të trajnimeve mjekësore të SOF | OF4 | USA | |
| OSO GTE 0070 | Koordinator i zhvillimit të trajnimeve të SOF | OR8 | ITA | |
| OSO GTE 0080 | Koordinator i zhvillimit të trajnimeve të SOF | OR7 | CZE* | *Në fuqi në 2011 |
| | Doktrina dhe standardet | | | |
| OSO GTD 0010 | Drejtues i degës për doktrinën dhe standardet | OF4 | GRC | |
| OSO GTD 0030 | Hartues i doktrinës | OF4 | USA | |
| OSO GTD 0040 | Hartues i doktrinës | OF4 | POL | |
| OSO GTD 0080 | Hartues i standardeve | OF3 | FRA | |
| OSO GTD 0090 | Hartues i standardeve | OR7 / OR8 | USA | |
| OSO GTD 0100 | Hartues i standardeve | OF3 | USA | |

SHTOJCA C
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC
TERMAT E REFERENCËS SË KOMITETIT TË LARTË TË POLITIKAVE DHE BURIMEVE

Përkufizime dhe referenca

1.1 Komiteti i Lartë i Politikave dhe Burimeve (SPRC) është komiteti përgjegjës për të shqyrtuar dhe vendosur mbi çështjet e politikave dhe burimeve që rrjedhin nga ajo pjesë e buxhetit të NSCC, i cili do të ndahet ndërmjet pjesëmarrësve dhe për zgjidhjen e çështjeve që rrjedhin nga administrimi i asaj pjese të buxhetit të NSCC. SPRC do të jetë gjithashtu përgjegjëse për ndryshimet në sigurimin e burimeve njerëzore të NSCC, në përputhje me shtojcën B.

1.2 Komitet teknik vartës (si p.sh. Komiteti Financiar) është çdo komitet ose grup pune i ngritur nga SPRC. Komitetet teknike vartëse do të sigurojnë rekomandimet e SPRC, të cilat do të marrin formën e vendimeve pasi të miratohen nga SPRC në përputhje me paragrafin 2.5 më poshtë.

1.3 SPRC dhe komitetet e tij vartëse do të përdorin gjuhën angleze në të gjitha komunikimet dhe dokumentet.

Përbërja

2.1 Secili nënshkrues do të emërojë një përfaqësues në SPRC dhe në secilin komitet teknik vartës që mund të ngrihet nga SPRC.

2.2 Secili nënshkrues mund të këshillohet nga ekspertët e vet, të cilat mund të marrin pjesë në çdo diskutim në takimet e SPRC ose të komiteteve teknike vartëse.

2.3 Kryetari dhe sekretari i SPRC do të sigurohen nga vendi kuadër. Kryetari dhe sekretari nuk do të kenë të drejtë vote në SPRC.

2.4 Drejtori i NSCC dhe /ose i emëruari /e emëruara e tij ose e saj do të ndjekin punimet e SPRC, por nuk do të kenë të drejtë vote.

2.5 SPRC do të përcaktojë organizimin dhe rregullat e saj të brendshme ndërsa do t'i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të mëposhtme:

a) SPRC do të mblidhet në intervale të rregullta, të paktën një herë në vit, për t'i dhënë atij mundësinë që të përmbushë përgjegjësitë e tij sa më shpejt që të jetë e mundur në përgjigje të një kërkese specifike nga cilido prej nënshkruesve ose nga NSCC.

b) Vendimet e SPRC do të merren me unanimitet. SHAPE do të ketë të drejtë vote vetëm në çështje që lidhen me organigramën dhe me përshkrimet e punës.

2.6 Kryetari i SPRC ka përgjegjësinë që të sigurojë që programi i parashikuar dhe dokumentet mbështetëse t'i dërgohen të gjithë nënshkruesve të paktën 30 ditë përpara mbledhjeve të SPRC.

Autoriteti

3.1 SPRC do të jetë përgjegjëse për:

a) miratimin e buxhetit vjetor të financuar shumëkombëtarisht dhe do të quajë si udhëzim planifikues planin financiar afatmesëm. Buxhetet do të paraqiten të paktën 30 ditë përpara me hollësi të mjaftueshme për t'i mundësuar vendet që të kuptojnë qartë se cilat veprimtari buxhetore po financohen dhe pse. Vendet do të kenë gjithmonë të drejtën që të kërkojnë informacione shtesë për veprimtaritë buxhetore.

b) Shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që rrjedhin nga administrimi i atij buxheti.

c) Miratimin e çdo veprimtarie financiare që tejkalon kufijtë e vendosur financiarë (EFL) që mund të jenë caktuar nga SPRC.

d) Miratimin e deklaratës financiare vjetore.

e) Autorizimin e kontrolleve financiare të kryera nga Bordi Ndërkombëtar i Auditëve (IBAN) mbi buxhetin e përbashkët të NSCC dhe shpenzimet e saj.

f) Vendimmarrjen mbi çdo ndryshim që propozohet për shtojcat B, E dhe F të këtij Memorandumi Mirëkuptimi (MoU).

g) Shqyrtimin dhe negocimin me vendet aplikuese të kushteve të notave të anëtarësimit dhe rekomandimin e përfundimeve të tyre ndaj nënshkruesve. Në negociata do të përfshihet edhe një vlerësim i tarifave të anëtarësimit për vendet aplikuese.

h) Miratimin, në mbledhjen e tij të parë, të grupit fillestar të JD të NSCC.

3.2 Duke marrë parasysh se SPRC nuk është një organ i përhershëm, asnjë vendim nuk do të merret sipas procedurave të heshtura.

SHTOJCA D
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC
TERMAT E REFERENCËS SË DREJTORIT TË NSCC

1.1 Drejtori i NSCC është përgjegjës për të siguruar që SACEUR dhe komandantët vartës të ACO të marrin konsulencë efikase dhe në kohën e duhur mbi planifikimin, sigurimin e burimeve njerëzore dhe kryerjen e operacioneve speciale.

1.2 Drejtori i NSCC i raporton SACEUR mbi çështje operacionale dhe SPRC mbi çështjet financiare, financimet dhe çështje të tjera që lidhen me SPRC.

1.3 Detyrat e drejtorit të NSCC janë:

a) Drejton të gjitha aspektet e mbështetjes ndaj SOF të NATO-s duke përfshirë këtu politikat, gjenerimin e forcës, ndërveprueshmërinë dhe trajnimin e SOF të aleancës.

b) Bashkërendon me SHAPE dhe me shtabin kombëtar të vendit të Aleancës në zhvillimin e politikave dhe procedurave të forcave të operacioneve speciale të NATO-s.

c) Ndërvepron me shtabin SACT, pas bashkërendimit paraprak me SHAPE, mbi çështjet e shndërrimit (doktrina, mësimet e nxjerra etj.) në lidhje me SOF të NATO-s.

d) Drejton dhe mbikëqyr veprimtaritë e të gjitha elementeve të NSCC.

e) Përmbush detyra të tjera sipas udhëzimeve.

1.4 Drejtori i NSCC informon shkurtimisht mbi politikat, buxhetin dhe veprimtaritë operacionale që ndërmerren nga NSCC dhe do të informojë shkurtimisht për PSRC mbi veprimtaritë e ardhshme buxhetore dhe operacionale.

SHTOJCA E
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC

MODELI I NOTËS SË ANËTARËSIMIT:
NOTË E ANËTARËSIMIT
PËR PJESËMARRJE NË MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
(LISTA E VENDEVE NËNSHKRUESE)
NË LIDHJE ME NGRITJEN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE SIGURIMIN ME BURIME NJERËZORE TË QENDRËS SË NATO-S PËR BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)

Sekretari/Ministri/Ministria i/e Mbrojtjes/Shtabi i Përgjithshëm i _____

Pasi kanë vendosur që të marrin pjesë në organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe sigurimin me burime njerëzore të qendrës së NATO-s për Bashkërendimin e Operacioneve Speciale (NSCC),

Zgjedhin që të marrin pjesë si pjesëmarrës dhe të veprojnë në përputhje me rregullimet e bëra në:

"Memorandumin e Mirëkuptimit" ndërmjet ..... (vendet nënshkruese) në lidhje me ngritjen, organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe sigurimin me burime njerëzore të qendrës së NATO-s për bashkërendimin e operacioneve speciale, e cila ka hyrë në fuqi më .....

Nënshkruar në një kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Sekretarin/Ministrin/Ministrinë e Mbrojtjes/Shtabin e Përgjithshëm të ..... (të gjithë pjesëmarrësit)

Data: .....

Për Sekretarin/Ministrin/Ministrinë e Mbrojtjes/Shtabin e Përgjithshëm të ..... (pjesëmarrësi që anëtarësohet)

.....

.....

Data: .....

SHTOJCA F
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC

SHKURTIME

| **Shkurtimi** | **Kuptimi** |
|---|---|
| AACP – 1 | Publikimi nr.1 i praktikave të blerjeve të aleancës |
| AAP – 6 | Publikimet Administrative të Aleancës, nr.6, Fjalori i Termave dhe Përkufizimeve të NATO-s |
| AC/35 – D/2001 | Direktiva e Komitetit të Sigurisë së NATO-s mbi Sigurinë Fizike |
| ACCI | Komanda e Kundërzbulimit të Aleancës |
| ACO | Operacionet e Komandës së Aleancës |
| AD 45 – 1 | Direktiva 45 – 1 e ACO, Drejtimi dhe menaxhimi personelit |
| AD 65 – 3 | Direktiva 45 – 1 e ACO, Politika e kundërzbulimit në ACO |
| C – M (2002) 49 | Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior |
| CFF | Kërkesë për fonde |
| CJTF | Task forca (grupe pune) të përbashkëta të përziera |
| EFL | Kufijtë e vendosur financiarë |
| IBAN | Bordi Ndërkombëtar i Auditëve për NATO-n |
| IMHQ | Shtabi Ndërkombëtar Ushtarak |
| MC 128/5 | Dokumenti i Komitetit Ushtarak nr.128/5, Udhëzues i politikave për Zbulimin e NATO |
| MC 167 | Dokumenti i Komitetit Ushtarak nr.167, Nxjerrja e informacionit ushtarak të klasifikuar dhe të paklasifikuar të NATO-s ndaj vendeve dhe organizatave joanëtare të NATO-s |
| MC 317 | Dokumenti i Komitetit Ushtarak nr.317, struktura e forcave të NATO-s |
| MC 534 | Dokumenti i Komitetit Ushtarak nr.534, Koncepti i Qendrës së Mbledhjes së Informacionit të Zbulimit |
| MoU | Memorandum Mirëkuptimi |
| NAC | Këshilli i Atlantikut të Veriut |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut |
| NGO | Organizatë joqeveritare |
| NRF | Forca e kundërpërgjigjes së NATO-s |
| NSCC | Qendra e NATO-s për bashkërendimin e operacioneve speciale |
| Protokolli i Parisit | Protokolli mbi statusin e Shtabit Ndërkombëtar Ushtarak |
| PO (2005) 98 | Politika e rishikuar e financimeve për operacione të udhëhequra nga NATO-ja jo sipas nenit 5 |
| SACEUR | Komandanti Suprem i Aleancës për Europën |
| SHAPE | Shtabi Suprem i Fuqive Aleate për Europën |
| SOCEUR | Komanda Supreme e Aleancës për Europën |
| SOF | Forcat e Operacioneve Speciale |
| SOFA | Marrëveshja mbi statusin e forcave |
| SNR | Përfaqësues i lartë kombëtar |
| SPRC | Komiteti i Lartë për Politikat dhe Burimet |
| USEUCOM | Komanda Europiane e Shteteve të Bashkuara |

SHTOJCA G
E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR NSCC

DEKLARATA INTERPRETUESE
MBI MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT (MOU)
NË LIDHJE ME NGRITJEN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN
DHE SIGURIMIN ME BURIME NJERËZORE TË QENDRËS SË NATO-S PËR
BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)

Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk kanë për qëllim që të vënë në dyshim denoncimin e Protokollit të Parisit mbi Statusin e Shtabit Ndërkombëtar, të datës 28 gusht 1952, të vendosur nga Franca më 30 mars 1966.

Komandat strategjike të NATO-s dhe komandat në varësi të tyre nuk kanë të drejtë të shfrytëzojnë pozitën e tyre juridike (ligjore) në emër të Francës. Në këtë mënyrë, zotimet ndërkombëtare të ndërmarra nga komandat strategjike nuk janë të detyrueshme ligjërisht për Republikën Franceze, përveçse kur parashikohet ndryshe nga kjo palë.

SHTESË
NË MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT
NË LIDHJE ME NGRITJEN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN
DHE SIGURIMIN ME BURIME NJERËZORE TË QENDRËS SË NATIO-S PËR
BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)

Komanda e Lartë e Forcave Aleate për Europën

Duke pasur parasysh që Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) shtator 2009 miratoi nëpërmjet referencës PO (2009) 0135-AS1 organizimin e NSCC si komandë e operacioneve speciale (NSHQ) e SHAPE dhe për aq sa kjo ndikon në Memorandumin aktual të mirëkuptimit, thekson në përputhje me vendimin në fjalë të NAC se:

Sigurimi me burime njerëzore të komandës së operacioneve speciale (NSHQ) do të jetë në përputhje me NSCC. Vendet pjesëmarrëse do të vazhdojnë t'i sigurojnë burime njerëzore NSHQ, si një organizatë e krijuar nga Memorandumi i Mirëkuptimit (MoU);

Vendet pjesëmarrëse do të vazhdojnë të financojnë NSHQ si një organizatë shumëkombëshe në përputhje me memorandumin e mirëkuptimit për NSCC;

Komanda e Operacioneve Speciale (NSHQ) vazhdon të jetë një organizatë ushtarake e NATO-s me status ndërkombëtar të siguruar nga dokumenti C-M (69) 22 i datës 19 maj 1969;

Komanda e operacioneve speciale (NSHQ) do të vazhdojë të jetë në varësi të drejtpërdrejtë të SACEUR për çështjet që lidhen me operacionet speciale, e atashuar pranë SHAPE, si një organizatë e krijuar nga MoU, e cila financohet nga shteti kuadër;

Rregullimet në lidhje me sigurimin me burime njerëzore të NSCC dhe kostot e rikrijimit të qendrës si një komandë për operacionet speciale (NSHQ) do të organizohen nga shteti kuadër në bashkëpunim me vendet pjesëmarrëse.

Karl-Heinz Lather
Gjeneral DEU A
Shefi i Shtabit

Datë 9 tetor 2009